Ngarkesa maksimale 7 Kg Fuqia e përhithur në off-mode 0,5 W / në left-on mode 8 W							Detergjente dhe Solucione shtesë		Detergjenti që këshillohet		Lagështira e mbetur % (***)	Konsumi energjetik kWh	Ujë gjithsej lt	Temperatura e rrobave °C
Programi	Temperatura		Centrifuga maksimale (xhiro)	Ngarkesa max (kg)	Kohëzgjatja (h : m)	Larje	Zbutës	Pluhur	Lëng					
	Cilësim	Range				1	2							
1	Antinjollë 40°	40°C	☼ - 40°C	1200	7,0	**	●	○	✓	-	-	-	-	-
2	Antinjollë i shpejtë	40°C	☼ - 40°C	1200	3,5	**	●	○	-	✓	-	-	-	-
3	Të pambukta (2)	40°C	☼ - 60°C	1200	7,0	3:50	●	○	✓	✓	50	0,98	75	45
4	Sintetike (3)	40°C	☼ - 60°C	1200	3,5	2:55	●	○	✓	✓	35	0,86	60	43
5	I shpejtë 30'	30°C	☼ - 30°C	1200 (****)	3,0	0:30	●	○	-	✓	73	0,19	31	27
6	Rifreskim Avull	-	-	-	1,5	**	-	-	-	-	-	-	-	-
7	Të përziera	40°C	☼ - 40°C	1200	7,0	**	●	○	-	✓	-	-	-	-
8	Lesh	40°C	☼ - 40°C	800	1,5	**	●	○	-	✓	-	-	-	-
9	Eco 40-60 (1)	40°C	40°C	1151	7,0	3:25	●	○	✓	✓	53	0,75	52	37
				1151	3,5	2:42	●	○	✓	✓	53	0,41	41	30
				1151	2,0	2:35	●	○	✓	✓	53	0,29	41	22
10	20°C	20°C	☼ - 20°C	1200	7,0	1:50	●	○	-	✓	52	0,16	64	22
11	Rroba të bardha	60°C	☼ - 90°C	1200	7,0	2:30	●	○	✓	✓	52,1	1,36	74,8	55
12	Antialergji	60°C	40°C - 60°C	1200	4,0	**	●	○	✓	✓	-	-	-	-
13	Mëndafsh dhe Perde	30°C	☼ - 30°C	600 (****)	1,0	**	●	○	-	✓	-	-	-	-
14	Peshqirë e çarçafë	60°C	☼ - 60°C	1200	7,0	**	●	○	✓	✓	-	-	-	-
	Shpëlarje dhe Centrifugë	-	-	1200	7,0	**	-	○	-	-	-	-	-	-
	Centrifugë dhe Shkarkim *	-	-	1200	7,0	**	-	-	-	-	-	-	-	-

● Doza që duhet ○ Doza opsionale

Kohëzgjatja e ciklit që tregohet në ekran ose në broshurë është një vlerësim i përllogaritur në bazë të kushteve standarde. Koha aktuale mund të ndryshojë nga shumë faktorë, si temperatura dhe presioni i ujit në hyrje, temperatura e ambientit, sasia e detergjentit, sasia dhe lloji i ngarkesës, balancimi i ngarkesës, opsionet shtesë të zgjedhura. Vlerat e treguara për programe të tjera, veç ciklit Eco 40-60, janë të përafërta.


1) Eco 40-60 - Cikël larës i testuar në përputhje me rregulloren Ecodesign të BE-së 2019/2014. Programi më i efektshëm për sa i përket konsumit të ujit dhe të energjisë për të larë veshje pambuku mesatarisht të pista. Shënim: Shpejtësitë e centrifugës që shfaqen në ekran mund të ndryshojnë paksa nga ato të treguara në tabelë.

Për të gjitha Institutet e testimit:

- 2) Program i gjatë për të pambukta: vendosni programin 3 me temperaturë 40°C.
- 3) Program i gjatë për sintetike: vendosni programin 4 me temperaturë 40°C.

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT


1. Syprina e punës
2. Vasketë detergjentësh
3. Paneli i kontrollit
4. Doreza
5. Dera
6. Pompa e shkarkimit (prapa xokolit)
7. Xokoli (që hiqet)
8. Këmbë të rregullueshme (2)



VASKETË DETERGJENTËSH

Ndarja *:

Mos vendosni detergjent në këtë ndarje.
Ndarja 1: Detergjent larës (pluhur ose lëng)
 Nëse përdorni detergjent të lëngshëm, për të vënë dozën e duhur, këshillohet të përdorni ndarësen **A** që jepet.
 Nëse përdorni detergjent pluhur ndarësen vendoseni në zgavrën **B**.
Ndarja 2: Solucione shtesë (zbutës rrobash, etj.)
 Zbutësi i rrobave nuk duhet të tejkalojë shenjën "MAX".



! Përdorni detergjente pluhur për rroba të bardha pambuku, për paralarje dhe për larje në temperatura mbi 60°C.
! Ndiqni udhëzimet në paketimin e detergjentit.

PROGRAMET

Ndiqui rekomandimet që tregohen te simbolet e larjes së rrobave. Vlera e treguar në simbol është temperatura maksimale që këshillohet për larjen e rrobave.



Antinjollë 40°

Programi 1 është për larjen e rrobave shumë të pista, me ngjyra rezistente. Programi garanton një klasë larëse më të lartë se klasa standarde (klasa A). Mos e përdorni programin duke përzier rroba me ngjyra të ndryshme. Këshillohet të përdoret detergjent pluhur. Njollat e forta këshillohet të trajtohen paraprakisht me solucione shtesë specifike.

Antinjollë i shpejtë

Programi është krijuar për të larë në një orë rrobat me njolla të përditshme, edhe ato më të forta. I përshtatshëm për rroba me ngjyra prej fibrash të përziera, duke garantuar kujdes maksimal.

Të pambukta

Për të larë peshqirët, ndërresat e brendshme, mbulesat e tavolinës etj., që janë prej pambuku dhe liri rezistent, nga mesatarisht të pista deri në shumë të pista.

Sintetike

Specifik për të larë rroba sintetike. Kur ka papastërti më rezistente, mund të rritet temperatura deri në 60° dhe të përdoret edhe detergjent pluhur.

I shpejtë 30'

Për të larë rroba pak të pista në një kohë të shkurtër. Nuk është i përshtatshëm për rroba leshi, mëndafshi dhe larje me dorë.

Rifreskim Avull

Ky program mundëson rifreskim të rrobave dhe heq aromat e pakëndshme e shtendos fibrat (1,5 kg, afërsisht 3 artikuj). Futni vetëm rroba të thata (jo të pista) dhe zgjidhni programin 6. Në fund të ciklit rrobat do të jenë pak të njoma dhe mund të jenë gati për t'u veshur pas disa minutash. Programi 6 lehtëson hekurrosjen.

! Nuk këshillohet për rroba leshi ose mëndafshi.

! Mos shtoni zbutës ose detergjent larës.

Të përziera

Për të larë bashkë rroba të përziera dhe me ngjyra.

Lesh - Wool Care

Ciklin larës për Lesh të kësaj lavatriçeje, The Woolmark Company e ka miratuar për rroba leshi që lahen në lavatriçe, me kusht që larja të kryhet sipas udhëzimeve në etiketën e rrobave dhe udhëzimeve të prodhuesit të lavatriçes. Simboli Woolmark është një shenjë certifikimi e vlefshme në shumë vende. (M2237)



Eco 40-60

Për larjen e rrobave të pambukta mesatarisht të pista, mund të lahen në 40°C ose 60°C të gjitha në të njëjtin cikël. Është programi standard për larjen e pambukut dhe më i efektshmi për sa i përket konsumit të ujit dhe të energjisë.

! Cikli funksionon vetëm në 40°C siç është rregulluar.

20°C

Për larjen e rrobave të pambukta pak të pista në një temperaturë prej 20°C.

Rroba të bardha

Rroba të bardha dhe me ngjyra rezistente, shumë të pista.

Antialergji

Për heqjen e alergjenëve kryesorë si poleni, këpushat, qimet e macës dhe të qenit.

Mëndafsh

Për të larë të gjitha rrobat prej mëndafshi. Këshillohet përdorimi i një detergjenti specifik për rroba delikate.

Perde

Rekomandohet t'i palosni dhe t'i vendosni në një këllëf jastëku ose qese rrjetë.

Peshqirë e çarçafë

Për të larë peshqirë dhe çarçafë në një cikël të vetëm, përdorni programin 14 që optimizon përdorimin e zbutësit të rrobave dhe lejon të kurseni kohë dhe energji. Këshillohet të përdoret detergjent pluhur.

Shpëlarje dhe Centrifugë


Projektuar për të shpëlarë dhe centrifuguar.

Centrifugë dhe Shkarkim

Projektuar për të centrifuguar dhe shkarkuar ujin.

EKRANI

Ekranin është i dobishëm për programimin e lavatriçes dhe ofron shumë informacione.



Në seksionin **A** shfaqet kohëzgjatja e programeve të ndryshme të disponueshme dhe, pasi ka filluar ciklin, koha e mbetur deri në fund të tij (ekrani do të tregojë kohëzgjatjen maksimale të ciklit të zgjedhur që mund të zvogëlohet pas disa minutash, meqë kohëzgjatja aktuale e programit ndryshon në bazë të ngarkesës së rrobave dhe të cilësimeve të vëna); nëse është vënë një FILLIM MË VONË, shfaqet koha e mbetur deri në nisjen e programit të zgjedhur.

Për më tepër, duke shtypur tastin përkatës, shfaqen shpejtësia maksimale e centrifugës dhe temperaturat maksimale që mund të arrijë pajisja në bazë të programit të zgjedhur ose të cilësimeve të fundit të përzgjedhura, nëse përputhen me programin e zgjedhur.

Në seksionin **B** shfaqen "fazat e larjes" të përcaktuara për ciklin e zgjedhur dhe, kur nis programi, "fazat e larjes" që po kryhen:

Larje

Avull

Shpëlarje

Centrifugë / Shkarkim

Në seksionin **C**, duke filluar nga e majta, shfaqen ikonat "temperatura", "centrifuga" dhe "fillimi më vonë".

Shiritat "temperatura" * tregojnë nivelin e temperaturës në raport me maksimumin që mund të përzgjidhet për atë cikël.

Shiritat "centrifuga" tregojnë nivelin e centrifugës në raport me maksimumin që mund të përzgjidhet për atë cikël.

Simboli i ndezur në ekran shfaq vlerën e zgjedhur për "Fillim më vonë".

LLAMBA E KONTROLLIT DERË E BLOKUAR

Simboli i ndezur tregon se dera është e bllokuar. Për të shmangur dëmtimet, përpara se të hapni derën, duhet të prisni që të fiket simboli. Për të hapur derën ndërsa është në punë një cikël, shtypni tastin NISJE/PAUZË ; nëse simboli është i fikur, mund të hapni derën.

PËRDORIMI PËR HERË TË PARË

Pas instalimit, përpara përdorimit, kryeni një cikël larës me detergjent dhe pa rroba duke vendosur programin "Vetëpastrim".

PËRDORIM I PËRDITSHËM

Përgatitni rrobat duke ndjekur rekomandimet në seksionin "KËSHILLA DHË SUGJERIME".

- Shtypni tastin ON/OFF ; llamba e kontrollit të tastit NISJE/PAUZË do të pulsojë ngadalë me ngjyrë jeshile.

- Hapni derën. Futni rrobat, duke pasur kujdes që të mos tejkaloni sasinë e ngarkesës që tregohet në tabelën e programeve.

- Tërhiqni vasketën dhe hidhni detergjentin në ndarjet e caktuara si u shpjegua në seksionin "VASKETA E DETERGJENTEVE".

- Mbyllni derën.

- Zgjidhni ciklin larës që dëshironi.

- Lavatriçja shfaq automatikisht temperaturën maksimale dhe centrifugën maksimale të përcaktuar për programin e zgjedhur ose cilësimet e fundit të zgjedhura, nëse përputhen me atë program. Kur shtypet tasti temperatura zvogëlohet në mënyrë progresive deri në larje të ftohtë "OFF". Kur shtypet tasti centrifuga zvogëlohet në mënyrë progresive derisa ajo hiqet "OFF". Nëse tastet shtypen prapë, kthehen vlerat në maksimumin e lejuar për ciklin e zgjedhur.

- Zgjidhni opsionet që dëshironi.

NISJA E NJË CIKLI

Shtypni tastin NISJE/PAUZË .

Në fazën e përgatitjes së çdo cikli larës, dera bllokohet (simboli ndizet) dhe kazanin fillon të rrotullohet, pastaj dera zhblokohet (simboli fiket) dhe bllokohet prapë (simboli ndizet). Kërcitja që dëgjohet vjen nga mekanizmi bllokues i derës. Kur dera bllokohet, uji mbush kazanin dhe fillon faza e larjes.

VËNIA NË PAUZË E NJË PROGRAMI

Për të vënë në pauzë një larje, shtypni tastin NISJE/PAUZË ; llamba e kontrollit do të pulsojë me një ngjyrë ambër. Për të rinisur larjen nga momenti ku u ndërpre, shtypni përsëri tastin NISJE/PAUZË .

HAPNI DERËN, NËSE ËSHTË E NEVOJSHME



Pasi fillon një program, simboli ndizet për të treguar që dera nuk mund të hapet. Dera mbetet e bllokuar gjatë gjithë kohës që cikli vazhdon. Për të hapur derën kur ka filluar programi, për shembull për të shtuar ose hequr ca rroba, shtypni tastin NISJE/PAUZË për ta vënë në pauzë; llamba e kontrollit do të pulsojë me një ngjyrë ambër. Kur simboli nuk është i ndezur, mund të hapet dera. Shtypni përsëri tastin NISJE/PAUZË që të vazhdojë programi.

NDRYSHIMI I NJË CIKLI LARËS PASI KA FILLUAR

Për të ndryshuar një program pasi ka filluar, vëreni lavatriçen në pauzë duke shtypur tastin NISJE/PAUZË (llamba e kontrollit përkatës do të pulsojë me një ngjyrë ambër); më pas, zgjidhni ciklin që dëshironi dhe shtypni përsëri tastin NISJE/PAUZË .

! Nëse doni të anuloni një cikël pasi ka filluar, shtypni gjatë tastin ON/OFF . Cikli do të ndërpritet dhe lavatriçja do të fiket.


MBARIMI I PROGRAMIT

Tregohet në ekran me fjalën "END", kur do të fiket simboli  mund të hapet dera. Hapni derën, nxirrni rrobat dhe fikni lavatriçen. Nëse nuk shtypet tasti "ON/OFF" , lavatriçja fiket automatikisht pas rreth 10 minutash.

OPSIONE

- Nëse opsioni i zgjedhur nuk përputhet me programin e vendosur, drita e kontrollit do të pulsojë dhe opsioni nuk do të aktivizohet.
- Nëse opsioni i zgjedhur nuk përputhet me një program tjetër të vendosur më përpara, drita e kontrollit që lidhet me funksionin që ishte zgjedhur më parë do të pulsojë dhe do të aktivizohet vetëm i dyti, do të ndizet drita e kontrollit të opsionit të aktivizuar.

Higjienë Avull


Zgjedhja e këtij opsioni rrit efektivitetin e larjes sepse gjeneron avull që gjatë ciklit eliminon edhe bakteret e pranishme në fibra, ndërkohë që i trajton. Fusni rrobat brenda, zgjidhni programin që përputhet dhe zgjidhni opsionin .

! Ndërsa lavatriçja është në punë, dera mund të duket më pak transparente ngaqë formohet avull.


Shpëlarje shtesë

Zgjedhja e këtij opsioni rrit efektivitetin e shpëlarjes dhe siguron heqjen maksimale të detergjentit. Është i dobishëm për ata që kanë lëkurë veçanërisht të ndjeshme.


Fillim më vonë

Për të vendosur fillimin më vonë të programit të zgjedhur, shtypni tastin përkatës derisa të arrihet koha që dëshirohet të fillojë. Kur ky opsion është aktiv, në ekran ndizet simboli . Për të hequr fillimin më vonë, shtypni tastin derisa në ekran të shfaqet fjala "OFF".


Temperatura



Çdo program ka një temperaturë të paracaktuar. Nëse dëshironi të ndryshoni temperaturën, shtypni tastin . Temperatura shfaqet në ekran.

Centrifuga





Çdo program ka një shpejtësi centrifuge të paracaktuar. Nëse dëshironi të ndryshoni shpejtësinë e centrifugës, shtypni tastin . Temperatura shfaqet në ekran.

Lloji i larjes

Tasti  mundëson optimizimin e larjes në bazë të shkallës së ndotjes së rrobave dhe të intensitetit të larjes që dëshirohet.

Për rroba shumë të pista shtypni tastin  derisa të arrini në nivelin "Intensiv". Ky nivel garanton një larje me performancë të lartë ngaqë në fazën fillestare të ciklit përdor më shumë ujë dhe një lëvizje më të madhe mekanike dhe është i dobishëm për të eliminuar njollat më rezistente. Për rroba që nuk janë aq të pista ose për një trajtim më delikat të rrobave, shtypni tastin  derisa të arrini nivelin "Delikat". Cikli do të reduktojë lëvizjen mekanike për të garantuar rezultate larjeje perfekte për rrobat delikate.

BLOKIM TASTESH

Për të aktivizuar bllokimin e panelit të kontrollit, mbani të shtypur tastin  për rreth 2 sekonda. Simboli  i ndezur tregon që paneli i kontrollit është bllokuar (përveç tastit ON/OFF ). Kjo parandalon që programet të ndryshohen pa dashje), veçanërisht nëse ka fëmijë në shtëpi. Për të çaktivizuar bllokimin e panelit të kontrollit, mbani të shtypur tastin  për rreth 2 sekonda.

KËSHILLA DHE SUGJERIME

Ndajini rrobat sipas:

Llojit të copës (pambuk, fibra të përziera, sintetike, lesh, larje me dorë). Ngjyrës (ndajini rrobat me ngjyra nga të bardhat, lajini më vete rrobat e reja me ngjyra). Delikatësës (rroba të vogla - si çorape najloni - rroba me grepça - si sutjena - futini në një qese lecke).

Zbrasni xhepat

Objekte të tilla si monedhat ose çakmakët mund të dëmtojnë lavatriçen dhe kazanin. Kontrolloni kopsat.

Ndiqui rekomandimet për dozimin/solucionet shtesë

Për të optimizuar pastrimin, për të shmangur depozitimim e mbetjeve të bezdisshme të detergjentit në rroba dhe për të kursyer para, duke mos harxhuar detergjent tepër.

Përdorni temperatura të ulëta dhe cikle larëse më të gjata

Programet më të efektshme për sa i përket konsumit të energjisë janë zakonisht ato që funksionojnë në temperatura më të ulëta dhe që zgjatin më shumë.

Respektoni peshën e ngarkesës

Për të kursyer ujë dhe energji, ngarkojeni lavatriçen aq sa tregohet në tabelën "TABELA E PROGRAMEVE", pa e tejkaluar kapacitetin.

Zhurma dhe lagështia që mbetet

Ndikohen nga shpejtësia e centrifugës: sa më e lartë të jetë shpejtësia gjatë centrifugimit, aq më e fortë është zhurma dhe aq më pak lagështi mbetet.

MIRËMBAJTJA DHE KUJDESI

Për çdo operacion pastrimi dhe mirëmbajtjeje, fikeni dhe hiqeni lavatriçen nga priza. Mos e pastroni me lëngje të ndezshme.

Pastrojeni dhe mirëmbajeni periodikisht (të paktën 4 herë në vit).

Shkëputja e ujit dhe energjisë elektrike



Mbyllni rubinetin e ujit pas çdo larje. Kjo kufizon konsumimin e sistemit hidraulik të lavatriçes dhe eliminon rrezikun e rrjedhjeve.


Hiqeni spinën nga priza kur pastroni lavatriçen dhe kur i bëni mirëmbajtje.

Pastrimi i lavatriçes

Nga jashtë dhe pjesët prej gome mund të pastrohen me një leckë të njomë, me ujë të ngrohtë dhe sapun. Mos përdorni tretës ose gërryes Lavatriçja ka një program "Vetëpastrim" për pjesët e brendshme që duhet bërë pa asnjë lloj ngarkese brenda.

Për të ndihmuar me këtë program, mund të përdoren detergjenti (baras me 10% të asaj që këshillohet për rroba më pak të pista) ose solucionet shtesë specifike për pastrimin e lavatriçes. Këshillohet që programi i pastrimit të kryhet çdo 40 cikle larje.

Për të aktivizuar programin, shtypni njëkohësisht tastet  dhe  për 5 sek.

Programi do të fillojë automatikisht dhe do të zgjasë rreth 70 minuta. Për të ndalur ciklin shtypni tastin NISJE/PAUZË .

Pastrimi i vasketës së detergjenteve

Nxirrni vasketën duke e ngritur paksa dhe duke e tërhequr. Lajeni me ujë të rrjedhshëm; ky pastrim duhet bërë shpesh.

Kujdesi për derën dhe kazanin

Lëreni derën gjithnjë paksa të hapur që të mos krijohen erëra të këqija.

Pastrimi i pompës

Lavatriçja ka një pompë vetëpastruese që nuk ka nevojë për mirëmbajtje. Megjithatë, mund të ndodhë që objekte të vogla (monedha, kopsa) të bien në paradhomën që mbron pompën, e cila gjendet në pjesën e poshtme të saj.

! Sigurohuni që cikli i larjes të ketë përfunduar dhe hiqeni nga priza.

Për të hyrë në paradhomë:

1. hiqni kapakun në anën e përparme të lavatriçes, duke bërë levë me një kaçavidë në qendër dhe anash;
2. zhvidhosni kapakun e pompës së shkarkimit duke e rrotulluar në drejtim të kundërt të akrepave të orës: është normale që të dalë pak ujë;
3. pastrojeni me kujdes brenda;
4. vidhosni përsëri kapakun;
5. montoni përsëri kapakun dhe sigurohuni që para se ta shtyni, t'i kenii futur grepat në foletë e tyre.

Kontrolli i zorrës së furnizimit me ujë

Kontrolloni zorrën e furnizimit të paktën një herë në vit. Nëse ka plasaritje ose vrima të vogla duhet zëvendësuar: gjatë larjes, presioni i fortë mund të shkaktojë çarje të papritura.

! Mos përdorni kurrë zorrë të përdorura.

SISTEMI PËR BALANCIMIN E NGARKESËS

Përpara çdo centrifuge, që të mos ketë tepër dridhje dhe ngarkesa të shpërndahet në mënyrë të barabartë, kazanin rrotullohet pak më shpejtë sesa kur bën larjen. Nëse pas disa rrotullimeve ngarkesa nuk është balancuar ende siç duhet, lavatriçja e bën centrifugën me një shpejtësi më të ulët nga ajo e paracaktuar. Kur ka tepër çbalancim, lavatriçja, në vend që të bëjë centrifugën, bën shpërndarjen. Për një shpërndarje më të mirë të ngarkesës dhe për një balancim korrekt, këshillohet të përzihen rroba të mëdha me të vogla.

AKSESORË

Për të parë nëse aksesoret e mëposhtëm disponohen për këtë model lavatriçeje, kontaktoni Shërbimin tonë të Asistencës.

Kit për të vënë tharësen sipër

Me këtë aksesori mund ta vini tharësen sipër lavatriçes për të kursyer hapësirë dhe për ta mbushur e zbrazur më kollaj atë.

TRASPORTI DHE LËVIZJA

Mos e ngrini lavatriçen duke e kapur nga syprina sipër.

Hiqni spinën nga priza dhe mbyllni rubinetin e ujit. Kontrolloni që dera dhe vasketa e detergjenteve të jenë mbyllur mirë. Shkëputni zorrën e ngarkimit nga rubineti i ujit, më pas shkëputeni zorrën e shkarkimit. Hiqni gjithë ujin që u ka mbetur brenda dhe verëni në një mënyrë që të mos dëmtohen gjatë transportit. Vendosni prapë bulonat e transportit. Për t'i hequr bulonat ndiqni procedurën në të kundërt, siç tregohet te "Udhëzime për instalim".

DEMO MODE: për të çaktivizuar këtë funksion, fikni lavatriçen. Duke mbajtur të shtypur tastin "NISJE/PAUZË" >||| shtypni edhe tastin "ON/OFF" ⏻ brenda 5 sekondash dhe mbajini të dyja të shtypura për 2 sekonda.

ANOMALI DHE ZGJIDHJE

Mund të ndodhë që lavatriçja të mos funksionojë. Përpara se të telefononi Shërbimin e Asistencës, kontrolloni që të mos jetë një problem që zgjidhet lehtësisht duke përdorur listën e mëposhtme.


Anomalitë	Shkaqe të mundshme / Zgjidhja
Lavatriçja nuk ndizet.	Spina nuk është futur në prizë, ose jo aq sa të bëjë kontakt. Në shtëpi nuk ka korrent.
Nuk fillon cikli larës.	Dera nuk është mbyllur mirë. Tasti ON/OFF ⏻ nuk është shtypur. Tasti NISJE/PAUZË > nuk është shtypur. Nuk është hapur rubineti i ujit. Është vendosur një fillim më vonë.
Lavatriçja nuk ngarkon ujë (Në ekran del shkrimi "H2O").	Zorra që furnizon me ujë nuk është lidhur me rubinetin. Zorra është përthyer. Nuk është hapur rubineti i ujit. Nuk ka ujë në shtëpi. Uji nuk ka mjaft presion. Tasti NISJE/PAUZË > nuk është shtypur.
Lavatriçja e ngarkon dhe e shkarkon vazhdimisht ujin.	Zorra e shkarkimit nuk është instaluar 65-100 cm nga toka. Skaji i zorrës së shkarkimit është zhytur në ujë. Shkarkimi në mur nuk ka një dalje për ajrin. Nëse pas këtyre kontrolleve problemi nuk zgjidhet, mbyllni rubinetin e ujit, fikni lavatriçen dhe telefononi Shërbimin e Asistencës. Nëse e keni shtëpinë në katet e fundit të një ndërtese, mund të ndodhin fenomene sifonazhi, prandaj lavatriçja e ngarkon dhe e shkarkon vazhdimisht ujin. Për të eliminuar problemin, në treg ka valvula të posaçme antisifonazh.
Lavatriçja nuk shkarkon dhe nuk centrifugon.	Programi nuk përfshin shkarkimin: për disa programe duhet të niset manualisht. Zorra e shkarkimit është përthyer. Është bllokuar kanali i shkarkimit.
Lavatriçja dridhet shumë gjatë centrifugimit.	Kur është instaluar, kazani nuk është zhblokuar siç duhet. Lavatriçja nuk është në nivel. Lavatriçja është vënë shumë ngushtë mes mobilieve dhe murit.
Nga lavatriçja rrjedh ujë.	Zorra e furnizimit me ujë nuk është vidhosur mirë. Vasketa e detergjenteve është bllokuar. Zorra e shkarkimit nuk është fiksuar mirë.
Llambat e kontrollit për "Opsione" dhe NISJE/PAUZË > pulsojnë shpejt dhe ekrani shfaq një kod anomalie (p.sh.: F-01, F-..).	Fikni lavatriçen dhe hiqeni nga priza, prisni rreth 1 minutë pastaj ndizeni prapë. Nëse anomalia vazhdon, telefononi Shërbimin e Asistencës.
Formohet shumë shkumë.	Detergjenti nuk është i përshtatshëm për lavatriçe (duhet të jetë shkruar "për lavatriçe", "për larje me dorë dhe lavatriçe" ose të ngjashme). Është vënë tepër detergjent.

Për më shumë informacion mbi produktin, porosi të pjesëve të këmbimit, dokumentacion për politikën e kompanisë dhe rregulloret:

- Duke skanuar kodin QR të pajisjes
- vizitoni sajtin tonë <http://docs.hotpoint.eu> dhe faqen parts-selfservice.hotpoint.com
- Përndryshe, kontaktoni shërbimin tonë të asistencës pas shitjes (numri i telefonit gjendet në broshurën e garancisë). Kur të kontaktoni asistencën pas shitjes, jepini kodet që tregohen në pllakën identifikuese të produktit.

Për informacionet lidhur me riparime dhe mirëmbajtje, vizitoni sajtin www.hotpoint.com

Mund të gjeni më shumë informacion në lidhje me modelin tuaj në internet në <https://eprel.ec.europa.eu/>, e cila është databaza zyrtare e produkteve EPREL e Bashkimit Evropian. Pasi të zgjidhni kategorinë e produktit, vendosni ID-në e modelit të produktit. Identifikuesi i modelit përbëhet nga shkronja dhe numra dhe gjendet në pllakën e identifikimit, si Mod (shih imazhin në të djathtë).



PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA

Për çdo seancë pastrimi dhe mirëmbajtjeje, fikeni lavatriçen dhe hiqeni nga priza.
Mos përdorni lëngje të ndezshme për të pastruar lavatriçen.

PASTRIMI I PJESËS SË JASHTME TË LAVATRIÇES


Përdorni një leckë të butë të lagur për të pastruar pjesët e jashtme të pajisjes.

Mos përdorni pastrues për xhamat ose përdorim të përgjithshëm, pluhur gërryes ose produkte të ngjashme për të pastruar panelin e kontrollit - këto substanca mund të dëmtojnë printimet.

KONTROLLI I ZORRËS SË FURNIZIMIT ME UJË


Kontrolloni zorrën e hyrjes rregullisht për plasaritje dhe çarje. Nëse është dëmtuar, zëvendësojeni me një zorrë të re që mund ta merrni përmes shërbimit të mbështetjes pas shitjes ose shitësit specialist.

Në varësi të llojit të zorrës:



Nëse zorra e hyrjes ka një veshje transparente, kontrolloni në mënyrë periodike nëse ngjyra intensifikohet në zona lokale.


Nëse po, zorra mund të ketë rrjedhje dhe duhet të zëvendësohet.




Për zorrët e ujit me valvulë mbyllëse: kontrolloni dritaren e inspektimit të valvulës së vogël të sigurisë (shikoni shigjetën). Nëse është e kuqe, është aktivizuar funksioni i ndalimit të ujit dhe zorra duhet të zëvendësohet me një të re. Për të zhvidhosur këtë zorrë, shtypni butonin e nxjerrjes (nëse disponohet) ndërsa zhvidhosni zorrën.

PASTRIMI I FILTRAVE RRJETË NË ZORRËN E FURNIZIMIT ME UJË


1. Mbyllni rubinetin e ujit dhe zhvidhosni zorrën e hyrjes.




2. Pastroni me kujdes me anë të një furçe filtrin rrjetë në fund të zorrës.



3. Tani zhvidhosni manualisht zorrën e hyrjes në pjesën e pasme të lavatriçes. Nxirrni filtrin rrjetë nga valvula në pjesën e pasme të lavatriçes duke përdorur pincat dhe pastrojeni me kujdes.



4. Futeni sërish filtrin rrjetë. Lidhni sërish zorrën e hyrjes me rubinetin e ujit dhe lavatriçen. Mos përdorni vegla për të lidhur zorrën e hyrjes. Hapni rubinetin e ujit dhe kontrolloni nëse lidhjet janë të shtrënguara.



PASTRIMI I NDARJES SË DETERGJENTIT

Hiqni ndarjen duke e ngritur dhe duke e tërhequr për jashtë (shikoni figurën).


Lajeni nën ujë të rrjedhshëm; ky veprim duhet të përsëritet shpesh.




PASTRIMI I FILTRIT TË UJIT/SHKARKIMI I UJIT TË MBETUR

Fikeni dhe hiqni nga priza lavatriçen para se të pastroni filtrin e ujit ose të zbrazni ujin e mbetur. Nëse keni përdorur një program me ujë të ngrohtë, prisni derisa uji të ftohet para se ta zbrazni. Pastrojeni filtrin rregullisht çdo 3 muaj, për të parandaluar moszbrazjen e ujit pas larjes për shkak të bllokimit të filtrit. Nëse uji nuk mund të zbrazet, ekrani tregon që filtri i ujit mund të jetë bllokuar.


1. Hiqni panelin e bazamentit: Veproni siç tregohet në figurën e mëposhtme duke përdorur një kaçavidë.




2. Kontejneri për ujin e zbrazur: Vendosni një kontejner të ulët dhe të gjerë nën filtrin e ujit, në mënyrë që të mbledhni ujin e mbetur.




3. Zbrazni ujin: Rrotullojeni ngadalë filtrin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa të ketë dalë i gjithë uji. Lejoni rrjedhjen e ujit pa e hequr filtrin. Pasi kontejneri të mbushet, mbylleni filtrin e ujit duke e rrotulluar në drejtim të akrepave të orës. Boshatisni kontejnerin. Përsëriteni veprimin derisa të jetë zbrazur i gjithë uji.




4. Hiqni filtrin: Shtroni një rrobë pambuku poshtë filtrit të ujit, e cila mund të thithë një sasi të vogël të ujit të mbetur. Më pas hiqni filtrin e ujit duke e rrotulluar në drejtim të kundërt të akrepave të orës.



5. Pastroni filtrin e ujit: hiqni mbetjet në filtër dhe pastrojeni atë nën ujë të rrjedhshëm.



6. Futni filtrin e ujit dhe instaloni sërish kapakun e poshtëm: Futni sërish filtrin e ujit duke e rrotulluar në drejtim të akrepave të orës. Sigurohuni që ta rrotulloni deri aq sa të jetë e mundur; doreza e filtrit duhet të jetë në pozicion vertikal. Për të testuar shtrëngimin e filtrit të ujit, mund të hidhni rreth 1 litër ujë në ndarjen e detergjentit. Më pas, instaloni sërish kapakun e poshtëm.



TRANSPORTI DHE MENAXHIMI

Mos e ngrini asnjëherë pajisjen duke e mbajtur nga pjesa e sipërme.

1. Nxirrni spinën elektrike dhe mbyllni rubinetin e ujit.
2. Sigurohuni që dera dhe ndarja e detergjentit të jenë mbyllur siç duhet.
3. Shkëputni zorrën e hyrjes nga rubineti i ujit dhe hiqni zorrën e shkarkimit nga pika juaj e shkarkimit. Hiqni të gjithë ujin e mbetur nga zorrët dhe rregullojini ato në mënyrë që të mos dëmtohen gjatë transportit.
4. Rivendosni bulonat e transportit. Ndiqni në rend të kundërt udhëzimet për heqjen e bulonave të transportit të dhëna tek "Udhëzuesi i instalimit".

E rëndësishme: Mos e transportoni lavatriçen pa fiksuar bulonat e transportit.

SHËRBIMI I MBËSHTETJES PAS SHITJES

PARA SE TË TELEFONONI SHËRBIMIN E MBËSHTETJES PAS SHITJES

1. Shikoni nëse mund ta zgjidhni vet problemin me ndihmën e sugjerimeve të dhëna te seksioni **ZGJIDHJA E PROBLEMEVE**


2. Fikni dhe rindizni pajisjen për të parë nëse problemi vazhdon.

NËSE PROBLEMI VAZHDON EDHE PAS KONTROLLEVE TË MËSIPËRME, KONTAKTONI SHËRBIMIN MË TË AFËRT TË MBËSHTETJES PAS SHITJES

Telefononi numrin e treguar në dokumentin e garancisë për të marrë ndihmë.

Kur kontaktoni shërbimin tonë të mbështetjes së klientit pas shitjes, specifikoni gjithmonë:

- një përshkrim të shkurtër të problemit;
- llojin dhe modelin e saktë të pajisjes;



- numrin e shërbimit (numrin pas fjalës "Service" në pllakën e specifikimeve).

SERVICE 0000 000 00000



- adresën tuaj të plotë;
- numrin tuaj të telefonit.

Nëse kërkohen riparime, kontaktoni një shërbim të autorizuar të mbështetjes pas shitjes (për të garantuar që do të përdoren pjesë këmbimi origjinale dhe që riparimet do të kryhen saktë).